



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 133
Prishtinë, më 11 korrik 2013, ora 15.00

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 11 DHE 12 KORRIK 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në fillim të seancës, kryetari i GP të PDK-së, **Adem Grabovci** propozoi që pika **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për amnistinë** të hyjë në rend dite të mbledhjes së sotme plenare duke u bazuar në nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, që ka të bëjë me shmangien nga Rregullorja.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e kryetarit të GP të PDK-së.

Për propozimin e deputetit Adem Grabovci u deklaruan: Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+” dhe Goran Marinkoviq, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim propozimin për shmangie nga Rregullorja sipas nenit 84 të saj, për pikën - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për amnistinë.**

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 86,
Kundër----- 14,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit sipas nenit 84 për pikën - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për amnistinë.**

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për amnistinë,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë,
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar,
11. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

* * *

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për amnistinë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për amnistinë.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, e paraqiti raportin me rekomandime për Projektligjin për amnistinë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti Hydajet Hyseni, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari konstatoi se sipas votimit elektronik për praninë e deputetëve, në sallë janë 106 deputetë, ndërsa sipas numërimit fizik në sallë janë 107 deputetë.

Kryetari i njoftoi deputetët se për këtë projektligj kemi gjithsej 4 amendamente: Amendamenti nr.1 - i propozuar nga deputetja Lumnije Morina, amendamentet nr. 2, 3 dhe 4 - të propozuara nga deputetja Alma Lama.

Në lidhje me amendamentet e propozuara diskutuan deputetët Lumnije Morina dhe Alma Lama, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi nuk i miratoi asnjërin nga amendamentet e propozuara.

Kryetari konstatoi se sipas votimit elektronik për praninë e deputetëve, në sallë janë 103 deputetë, sipas kartelave të pranishëm janë 112 deputetë, ndërsa sipas numërimit fizik, në sallë janë 111 deputetë.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----90 ,
Kundër -----17,
Abstenime ----- 1 .

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/ L-209 për amnistinë.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013,

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Ministri Besim Beqaj tha se ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 është i bazuar në Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në vazhdim, ai tha se ndryshimet dhe plotësimet e parapara në këtë projektligj janë të harmonizuara edhe me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Në pas, ministri u fokusua në sqarimin e parametrave tjerë të organizatave buxhetore, të paraparë në Projektligj.

Në fund, ministri Besim Beqaj i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Kryetari më pas e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Jelena Bontiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, si dhe Halit Krasniqi, Hykmete Bajrami, Alma Lama, Hydajet Hyseni, Lutfi Haziri, Albulena Haxhiu, Ahmet Isufi, Muhamet Mustafa, Nijazi Idrizi, Liburn Aliu, Zenun Pajaziti dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 49,
Kundër ----- 35,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin në afatin sa më të shpejtë të mundshëm dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e mbylli mbledhjen plenare në orën 17:35 minuta për të vazhduar të premten, më 12 korrik 2013, në orën 10:00.

E premte, më 12 korrik 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 11 korrik

Mbledhjen e drejtoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.. Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 11 korrik 2013.

Ai procedoi me pikat si në vijim:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave.

Ministri Besim Beqaj tha se ky projektligj do t'i vendosë parimet dhe rregullat lidhur me sistemin rregullativ të veprimtarive private dhe publike në fushën e lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, ai tha se çështja rregullimit të lejeve dhe licencave është e një rëndësie të veçantë, andaj ky proces kërkon një mbikëqyrje specifike dhe të vazhdueshme, ndërsa sa u përket implikimeve buxhetore, ky projektligj nuk parasheh implikime të natyrës së tillë.

Më tej, ministri u fokusua në sqarimin e strukturës dhe përmbajtjes së këtij projektligji, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin sistemin e lejeve dhe licencave.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, si dhe Hashim Deshishku dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Hashim Deshishku tha se diskutimin e plotë të paraparë për këtë pikë do ta dorëzojë me shkrim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 34,
Kundër ----- 33,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision FunkSIONAL dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqiti deputetja Safete Hadërgjonaj.

Kryetari më pas hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më pas diskutoi deputeti Naser Osmani, i cili propozoi që Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion edhe një herë t'i rishqyrtojnë dhe harmonizojnë raportet me rekomandime lidhur me këtë projektligj.

Kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal të deklarohen lidhur me propozimin e lartpërmendur dhe kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për njërën nga mbledhjet e radhës.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion që t'i rishqyrtojnë dhe harmonizojnë rekomandimet lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion e kanë shqyrtuar vendimin e Presidentes së Kosovës për kthim në Kuvend të Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, propozoi që Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion edhe një herë t'i rishqyrtojnë dhe harmonizojnë Raportet me rekomandime lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Ajo propozimin e saj e arsyetoi me faktin se çështjet e diskutueshme janë të natyrës së njëjtë me ato të pikës paraprake të rendit të ditës.

Kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal të deklarohen lidhur me propozimin e lartpërmendur dhe kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për njërën nga mbledhjet e radhës.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Ngarkohen Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion që t'i rishqyrtojnë dhe harmonizojnë rekomandimet lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012

Kryetari i njoftoi deputetët se raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012 e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL e paraqiti dhe arsyetoi deputeti Zenun Pajaziti.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2012.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për masat mbrojtëse në importe dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Më tej, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hashim Deshishku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar KKR, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----59,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për masat mbrojtëse në importe.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012

Deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 dhe Kuvendit ia kemi paraqitur raportin me rekomandime.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Imri Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Bali Muharremaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar KKR, si dhe Ramiz Lladrovci, Salih Morina dhe Halit Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012, bashkë me rekomandimin e Komisionit funksional.

10. Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor Parlamentar

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, deputeti Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen plenare të radhës me arsyetim se asnjëri nga ministrat e Kabinetit qeveritar nuk janë të pranishëm në sallë.

Kryetari më pas kërkoi deklarin e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Në emër të grupeve parlamentare u deklaruan: Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar KKR; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”; Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ‘ZB’, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin për shtyrjen e kësaj pike për mbledhjen plenare të radhës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin për shtyrjen e kësaj pike për mbledhjen plenare të radhës.

11. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës

Kryetari i informoi deputetët se Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të kësaj agjencie.

Arsyetimin e raportit me rekomandime në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor e paraqiti deputeti Salih Morina.

Më tej, kryetari sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës, dhe i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Xhevahire Izmaku,
2. GP LDK - Afërdita Berisha-Shaqiri,
3. GP “Vetëvendosje” - Albana Gashi,
4. GP AAK - Bali Muharremaj,
5. GP KKR - Sevdije Lama,
6. GP SLS - Mursel Halili,
7. GP “6+” - Enis Kervan,
8. GP ‘ZB’ - Boban Todoroviq.

Kuvendi e miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti Xhevahire Izmaku.

Ajo konstatoi se në votim morën pjesë 83 deputetë, ndërsa të pavlefshme janë 11 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

1. Sefer Goxhuli ka fituar 22 vota ndërsa
2. Idriz Blakaj ka fituar 50 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Idriz BLAKAJ zgjidhet drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

2. Mandati i drejtorit nga pika 1. e këtij vendimi është pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

* * *

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 14:35.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*